

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaCeram[®]-203 SuperBond

KOLLË PLLAKASH ME PERFORMANCË TË PËRMIRËSUAR, TIKSOTROPIKE DHE ME BAZË ÇIMENTOJE, KATEGORIA C2TE SIPAS EN 12004



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaCeram[®]-203 SuperBond është një kollë çimentoje me performancë të përmirësuar, rrëshqitje të ulët, një ambalazhi, ngjyrë të bardhë dhe kohë të zgjatur punueshmërie që përmban agregate të përzgjedhura, aditivë të posaçëm dhe polimere.

SikaCeram[®]-203 SuperBond mund të përdoret për ngjitje pllakash deri në 10mm trashësi shtrese, për aplikime në mjedise të brendshme e të jashtme mbi sipërfaqe vertikale dhe horizontale.

PËRDORIMET

SikaCeram[®]-203 SuperBond mund të përdoret për ngjitjen e pllakave qeramike të mëposhtme:

- Pllaka qeramike monocottura, bicoturra
- Pllaka mesatare dhe të mëdha
- Pllaka graniti artificial (përfshihen pllakat grès porcelanato)
- Pllaka cotto dhe mozaik
- Mermer dhe gur natyror (pa asnjë ndjeshmëri ndaj ujit)

SikaCeram[®]-203 SuperBond mund të përdoret mbi nënshtresa të ndryshme si:

- Betoni dhe llaçi
- Pllaka ekzistuese mermeri, mozaik dhe qeramike
- Tulla, suva
- Nënshtresa joabsorbuese (me prajmer të përshtatshëm)

SikaCeram[®]-203 SuperBond mund të përdoret për dysheme dhe mjedise të brendshme e të jashtme, në zona vertikale dhe horizontale si:

- Kuzhina, ballkone, tarraca
- Banja, dushe
- Zona me qarkullim të shpeshtë

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Kohë e zgjatur punueshmërie
- Tepër tiksotropik, pa rrëshqitje vertikale
- Ndërkapje e shkëlqyer pothuajse mbi të gjitha llojet e nënshtresave
- Aplikim i shpejtë dhe i lehtë
- Rezistente ndaj kushteve të motit
- I aplikueshëm deri në 10 mm

MIRATIME / STANDARDE

Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 12004-1 - Kolla për pllaka qeramike

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	çimento Portland, agregate të përzgjedhura, aditivë të posaçëm dhe polimere
Ambalazhi	thes 25 kg
Paraqitja / Ngjyra	pluhur i bardhë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C.
Dendësia	Dendësia e llaçit të freskët: ~ 1,60 kg/l (në +23°C)

Përmasa maksimale e kokrrizës ~ 0,5 mm

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	≥ 1,0 N/mm ² (fillestare) ≥ 1,0 N/mm ² (pas vjetërimit me nxehtësi) ≥ 1,0 N/mm ² (pas zhytjes në ujë) ≥ 1,0 N/mm ² (pas cikleve ngrirje shkrirje)	(EN 12004-2)
Rezistenca ndaj rrëshqitjes	≤ 0,5 mm	(EN 12004-2)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	7,2 – 8,0 L ujë për thes 25 kg		
Konsumimi	Konsumimi varet nga profili i sipërfaqes dhe ashpërsia e nënshtresës, si dhe gjithashtu nga madhësia e pllakave dhe teknika e aplikimit të tyre (aplikim kolle vetëm tek njëra sipërfaqe) ose aplikim kolle mbi nënshtresë por edhe në pjesën e pasme të pllakës.		
	Përmasa e pllakës	Malla	Konsumimi
	Pllaka të vogla dhe mozaik	6 mm	~ 2 - 3 kg/m ²
	Pllaka normale (20x20cm - 45x45cm)	8 mm	~ 3 - 4 kg/m ²
	Pllaka mesatare dhe të mëdha	10 mm	~ 4 - 5 kg/m ²
	Nënshtresë shumë e ashpër/teknika e përhapjes nga 2 anët	12-15 mm	~ 5 - 7 kg/m ²
Trashësia e shtresës	max. 10 mm		
Temperatura e mjedisit	+5°C min. / +35°C max.		
Temperatura e nënshtresës	+5°C min. / +35°C max.		
Koha e punueshmërisë	~ 3-4 orë në +23 °C		
Koha e përpunimit	≥ 30 minuta (rezistenca e ndërkapjes në tërheqje ≥ 0,5 N/mm ²) (EN 12004-2)		
Koha e përshtatjeve	~ 30 min. në +23°C		
Produkti i aplikuar gati për përdorim	Përpara mbushjes së fugave në dysheme – qarkullim i lehtë	24* orë	
	Përpara mbushjes së fugave në mure	5-12* orë	
	Qarkullim i plotë	~14* ditë	

* Vlera në kushte laboratorike: 23°C ± 2°C - lagështi relative 50% ± 5%. Temperaturat e larta shkurtojnë kohët e treguara, ndërsa temperaturat e ulëta i zgjasin.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Në kushte normale, nuk kërkohet prajmer për aplikimin e produktit mbi nënshtresa çimentoje, suva, beton, pllaka ekzistuese, mozaik, mermer. Në rast nënshtresash shumë absorbuese, mund të përdoren prajmerat e mëposhtëm:

Nënshtresa	Prajmer
Nënshtresa porozo (pllaka gipsi, çimentoje, etj.)	Sika® Primer-11 W+
Dysheme PVC, linoleum, veshje epokside, suvatime gipsi, etj.	Sika® Primer-21 W
Izolues poresh / përmirësues ndërkapjeje mbi nënshtresa joporoze (p.sh. pllaka të vjetra)	SikaTop®-10
Nënshtresa metalike	Sikafloor®-156/161 (i spërkatur me rërë kuarci)

Për nënshtresa të tjera, ju lutemi këshillohuni me departamentin teknik. Për më tepër informacione, ju lutemi referohuni tek skeda teknike e prajmerit

përkatës që do të përdoret.

Nënshtresa nuk duhet të ketë kore çimentoje, papastërti, vaj, graso apo kontaminues të tjerë si grimcat e lira dhe të shkrifëta.

Nënshtresa duhet të jetë plotësisht e sheshtë, e qëndrueshme dhe në moshën e duhur. Çdo pjerrësi apo gunga të vogla mund të nivelohen dhe të mbushen me një shtresë SikaCeram®-203 SuperBond në trashësi max. 5 mm, e aplikuar të paktën 24 orë përpara shtrimit. Për trashësi më të mëdha, mund të përdoren llaçet e prodhuar në kantier me SikaLatex® Max ose Sika ViscoBond® ose llaçet për meremetim Sika MonoTop® ose SikaRep®.

Në rast kërkesash për nivelim të nënshtresës, mund të përdoren llaçet e vetënivelueshëm nga seria Sika® Level.

PËRZIERJA

Përzieni thesin 25 kg me sasinë e përshtatshme që përmendet më sipër të ujit, duke përdorur një përzierës elektrik me xhiro të ulët (500 rpm max, për shmangien e bllokimit të ajrit), në një kovë të pastër derisa të përftohet një pastë homogjene pa kokrriza. Pas përzierjes, lini produktin të qëndrojë për 5 min. dhe përzieni sërish përpara aplikimit. Përzierja e përftuar duhet të jetë shumë kremoze, lehtësisht e përhapshme dhe shumë tiksotropike.

APLIKIMI

SikaCeram®-203 SuperBond aplikohet me mallë të dhembëzuar. Sasia e produktit duhet të jetë e mjaftueshme për të siguruar mbulimin e plotë të pjesës së pasme të pllakës. Shtrimi i pllakave duhet bërë mbi kollën e freskët, duke ushtruar presion të mjaftueshëm për të siguruar kontaktin me kollën që ngjitja të jetë e përkryer. Në rast se formohet një cipë mbi kollë, nevojitet të kaloni sërish mallën mbi sipërfaqen e saj. Shmangni lagjen me ujë të kollës së aplikuar tashme, pasi kjo gjë ndikon negativisht tek procesi i ngjitjes. Masa e përshtatshme e mallës duhet bërë në përputhje me madhësinë e pllakës.

SikaCeram®-203 SuperBond mund të përdoret për fiksime të pllakave me absorbueshmëri të ulët:

Përmasa e pllakës	Përdorimi
Deri në 3.600 cm ² (p.sh. 60cm x 60cm)	Nënshtresa të jashtme & të brendshme dyshemeje
Deri në 2.100 cm ² (p.sh. 30cm x 60cm)	Nënshtresa të jashtme & të brendshme muri

Për shtrimin e pllakave me sipërfaqe totale 900 cm² (p.sh. 30x30 cm) dhe më të madhe, rekomandohet gjithnjë teknika e përhapjes së kollës në të dyja anët (mbi nënshtresë dhe në pjesën e pasme të pllakës).

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga veglat dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / maturuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Mos tejkaloni dozën maksimale të rekomanduar të ujit. Aplikoni vetëm mbi sipërfaqe të qëndrueshme dhe të përgatitura në mënyrën e duhur. Mos tejkaloni trashësinë maksimale të shtresës.
 - Nënshtresat me bazë gipsi duhet të kenë trashësi min. 10 mm dhe lagështi max. të përmbajtur 0,5%.
 - Nëse nevojitet hidroizolim shtesë nën pllaka, mund të përdoren produktet e mëposhtme: SikaTop® Seal-107 FL-X, Sikalastic®-152, Sikalastic®-1K, Sika® SealTape-S.
 - Mbroni materialin e freskët të aplikuar nga ngrirja, shiu etj. për të paktën 24 orë.
 - Nuk kërkohet lagia paraprake e pllakave
- Ju lutemi referohuni tek skedat teknike përkatëse ose kontaktoni me departmanetin tonë teknik.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaCeram®-203 SuperBond

Gusht 2019, Botimi 02.01

020404020010000349

SikaCeram-203SuperBond-sq-AL-(08-2019)-2-1.pdf